



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 56, datë 12.03.2021

**MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË PROKURORES ELIZABETA
IMERAJ, KANDIDATE PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe pasi u njoh me Relacionin "Mbi verifikimin e pasurisë, figurës të prokurores Elizabeta Imeraj, kandidate për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatës Elizabeta Imeraj, kandidate për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatës prokurore Elizabeta Imeraj të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Elizabeta Imeraj.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**



**ANËTAR
BUJAR SHESHI**



**ANËTAR
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
VATË STAKAJ**



**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**



**ANËTAR
MOISI DUDA**